

TË DHËNAT TEKNIKE

KOMP A-Konsistenca: Liquid	KOMP B-Konsistenca: Liquid
KOMP A-Ngjyra: Transparent	KOMP B-Ngjyra: Transparent
KOMP A-Viskoziteti: 250±20 cps	KOMP B-Viskoziteti: 500±20 cps
KOMP A-Densiteti: ±1,00 Kg/L	KOMP B-Densiteti: ±1,15 Kg/L
Ruajtja: 12 muaj te ruhet ne vende te thata magazinimi.	
Raporti miksimi: 100:20// 5:1 (Komp.A: Komp.B)	
Densiteti i përzierjes: ±1,05 Kg/L	
Viskoziteti: 120-130 KU (25°C)	
Koha e punueshmerise: 2- 3 ore ne 23°C	
Temperatura e aplikimit: +5°C deri ne +30°C	
Koha e riaplikimit: 4 ore ne varesi te kushteve atmosferike	
E shkëlshme pas: 24 oresh	
Koha e plotë e tharjes: 7 ditë	
Gloss: 20 GU (TQC)	
pH i përzierjes: ±8	
Përshkueshmëria nga avujt e ujit: Sd ≤ 5 m, (sipas EN ISO 7783-2)	
Thithja e ujit: W3 ≤ 0.1, (sipas EN ISO 1062-3)	
Rezistenca ne ngjitje me suportin: ≥1,5 MPa, (sipas UNI EN 1542)	
Rezistenca ne gervishtje: ca- 35 mg, (sipas ASTM D 4060)	

PINTOCOLOR®
TUTTI I MIEI COLORI



Dëshironi të dini më shumë mbi produktet tona?
Autostrada Tiranë - Durrës, Km 5.
www.dekoll.al | [+355 69 606 6656](tel:+355696066656) | info@dekoll.al



PINTOCOLOR®
TUTTI I MIEI COLORI

**PINTOPROTECT
PUR-25**



PËRSHKRIMI

Llak poliuretani transparent 2 komponente, me bazë uji . Karakterizohet nga rezistence e shkelqyeshme ndaj rrezatimit UV dhe kushteve klimaterike, qendrueshmeri e larte mekanike dhe kimike. I pershtatshem per aplikime ne ambiente te brendshme dhe te jashtme . PintoProtect PU 2K është një shtrese perfundimtare pa VOC (substancia organike volatile) dhe pa perberes solvente, me rezistencë të lartë ndaj konsumimit dhe gerryerjes. Filmi përfundimtar është rezistent ndaj ujit dhe detergjentëve të përdorur për pastrimin e dyshemesë apo papastertite ne mure, si dhe ndaj tretësirave acide dhe bazike me përqendrim të mesëm. Pas tharjes, PintoProtect PU 2K përmirëson vetitë mekanike të sipërfaqeve të trajtuara, duke siguruar thithje të ulët dhe rezistencë të lartë ndaj gerryerjes dhe njollave . Ideale për veshje mbrojtëse të produkteve dekorative me bazë çimento si Dekocement , Parket , Sipërfaqe druri. Aftesia e larte e ngjitjes e bën të përshtatshëm edhe për sipërfaqe qeramike etj.

PËRFITIMET

Produkt pa erë dhe pa VOC.

- I certifikuar sipas normës nderkombetare ISO 22000:2018
- Qëndrueshmëri e ngjyrës ndaj rrezeve UV.
- I përshtatshëm për ambiente të brendshme dhe të jashtme.
- Jetëgjatë dhe rezistent ne suporte me trafik te renduar.

FUSHA E APLIKIMIT

Mund të përdoret për veshjet e mureve te punuara me Dekocement .

- Industritë kimike dhe farmaceutike.
- Industritë mekanike.
- Zyra, muze, qendra tregtare, showroom.
- Depo mekanike, garazhe.
- Veshjet drurit dhe parketi.
- Ambiente me presence lageshtie , tualete etj .

PËRGATITJA E SIPËRFAQEVE DHE APLIKIMIT

Pastrimi paraprak: Suporti duhet të jetë i pastër, i thatë, pa lagështi, njolla vaji ose yndyre. Për produktet me baze çimento, sigurohuni që suporti të jetë plotësisht i maturuar .Rrafshimi: Për sipërfaqe shumë të lëmuara, përdorni letër abrasive ose zmerilim mekanik. Bashkoni Komponentin A me Komponentin B ne raportin 5: 1 dhe përzieni me një mixer me spirale me shpejtësi të ulët. Aplikoni me rul fije shkurter (gjatesi fije max 6-8mm). Rekomandohet te aplikohen te pakten 2 shtresa per rezultate optimale. Koha e tharjes: • 4 orë (pa pluhur). • 24 orë (për këmbësorë). • 7 ditë (ngurtësim i plotë).

